

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

**Auditim i avancuar dhe
siguria
(zgjidhjet)**

P10

Data 30/09/2017

Detyra 1

(a) Ju jeni menaxherë i auditimit përgjegjës për 'rishikime të nxehta' për klientë të përzgjedhur të auditimit brenda firmës tuaj të auditimit. Tani jeni duke rishikuar letrat e punës së auditimit për Dafi Shpk, një klient afat-gjatë, për vitin që përfundoj me 31 dhjetor 2016. Draft pasqyra e pozicionit financiar i Dafi Shpk paraqet pasuri gjithsej prej €12 milion (2015 - €11.5 milion). Seniori i auditimit ka bërë komentet në vijim për çështjet që duhet të rishikohen nga ju:

'Pasqyra e pozicionit financiar i Dafi Shpk paraqet të arkëtueshme që janë klasifikuar si pasuri qarkulluese në vlerë prej €25,000. E vetmja evidencë e auditimit që kemi kërkuar dhe marrë është përfaqësimi i menaxhmentit (letra e përfaqësimit) në të cilën thuhet:

(1) shuma është borxh nga Jani shpk,

(2) se Jani Shpk kontrollohet nga kryetari i bordit të Dafi Shpk, Arlind Bakia, dhe

(3) saldoja ka mundësi të inkasohet gjashtë muaj pas përfundimit të vitit të Dafi Shpk.

Llogaria e arkëtueshme e njëjtë ishte poashtu e pa inkasuar në fund të vitit të kaluar dhe shpjegimi identik nga menaxhmenti ishte bërë edhe atëherë, dhe në letrat tona të punës ishte shënuar se pasi që saldoja nuk ishte materiale nuk është konsideruar e nevojshme të bëhet punë shtesë.

Nuk është bërë ndonjë shpalosje në pasqyrat financiare sa i përket kësaj saldoje. Jani Shpk nuk është audituar nga firma jonë dhe ne kemi verifikuar se Dafi Shpk nuk posedon ndonjë aksion në Jani Shpk.'

Kërkohet:

Në lidhje me të arkëtueshmen e njohur në pasqyrën e pozicionit financiar të Dafi Shpk me 31 dhjetor 2016:

(i) Komentoni mbi çështjet të cilat duhet të konsideroni. (5 pikë)

(ii) Rekomandoni procedura shtesë të cilat duhet të kryhen. (5 pikë)

(b) Diskutoni çështjet e kontrollit të cilësisë të ngritura nga komentet e seniorit të auditimit. (5 pikë)

(c) Pasqyrat financiare të Ueki ShPK për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2016 përfshinin gjendjet e llogarive në vijim:

Fitimi para tatimit	€50,000
Stoqet	€25,000
Gjithsej pasuritë	€350,000

Stoqet përbëhen nga libra, ditarë, kalendarë dhe kartolina.

Kërkohet:

Lidhur me gjendjet fillestare kur pasqyrat financiare nuk ishin audituar në periudhën e mëhershme:

Shpjegoni procedurat e auditimit që kërkohen me SNA 510 *Angazhimet fillestare - Saldot fillestare*, dhe rekomandoni procedurat specifike të auditimit që duhet të kryhen gjatë auditimit të stoqeve të Ueki Shpk. (10 pikë)

(d) Shpjegoni termin 'raportimi financiar mashtrues', duke e ilustruar shpjegimin tuaj me shembuj. (5 pikë)

[Total: 30 pikë]

Zgjidhja

(b) (i) Çështjet që duhet konsideruar

Materialiteti

Të arkëtueshmet përfaqësojnë vetëm 0.2 % (25,000/12 mion x 100) të pasurive totale kështu që është jomateriale në terma monetar.

Mirëpo, detajet e transaksionit mund ta bëjnë këtë material për nga natyra.

Kjo shumë është e papaguar nga kompania që është nën kontroll të kryetarit të Dafi Shpk. Shfrytëzuesit e pasqyrave financiare do të ishin të interesuar dinë detajet e këtij transaksioni i cili momentalisht nuk është shpalosur. Elementet e këtij transaksioni mund të jenë të njëanshme, posaçërisht kushtet e pagesës, të cilat duken të jenë përtej kushteve normale të kreditimit komercial.

Arlind Bakia mund të ketë përdorur ndikimin e tij mbi të dy kompanitë për të 'prodhuar' këtë transaksion. Shpalosja është e domosdoshme për shkak të natyrës së transaksionit, vlera monetare nuk është relevante. Një çështje tjetër që duhet marrë parasysh këtu është pyetja nëse ky transaksion kishte ndodhur vetëm njëherë ose mund të jetë tregues për transaksione tjera në mes këtyre dy kompanive.

Standardet relevante të kontabilitetit

Definicionet në SNK 24 duhet të konsiderohen me kujdes për të përcaktuar nëse ky rast është transaksion me palë të ndërlidhura. Standardi veçanërisht thekson se dy entitete nuk janë domosdoshmërisht të lidhura vetëm nëse e kanë të përbashkët drejtorin ose ndonjë anëtarë tjetër të menaxhmentit. Seniori i auditimit thekson se Jani Shpk është i kontrolluar nga Arlind Bakia, i cili poashtu është kryetar i Dafi Shpk. Duket se Arlindi është në pozitë të kontrollojë ose ka influencë domethënëse mbi të dy kompanitë (edhe pse kjo duhet të qartësohet përmes procedurave të mëtutjeshme të auditimit) prandaj edhe këto dy kompani edhe perceptohen se janë palë të ndërlidhura.

SNK 24 kërkon shpalosje të plotë të çështjeve në vijim sa i përket transaksioneve me palë të ndërlidhura:

- natyra e marrëdhënies së palëve të ndërlidhura,
- shuma e transaksionit,
- shuma e çfardo saldoje të papaguar përfshirë kushtet e marrëveshjes, detajet e sigurimit të ofruar dhe natyrën e pagesës për shlyerjen e borxhit,
- çfardo lejimi për të arkëtueshmet dhe shpenzimet përkatëse.

Aktualisht ka shkelje të SNK 24 sepse nuk është bërë shpalosje në shënimet e pasqyrave financiare. Nëse nuk ndryshohen, opinion mbi pasqyrat financiare duhet të jetë me rezervë me një 'përveç për' mospajtim. Përveç kësaj, nëse është praktike, raporti i auditorit duhet të përmbajë informata të cilat do të duhet përfshirë në pasqyrat financiare nëse ishin respektuar kërkesat e SNK 24.

Vlerësimi dhe klasifikimi i të arkëtueshmeve

Një e arkëtueshme duhet të njohet vetëm nëse do të çoj në rritjen e përfitimit ekonomik në të ardhmen, dmth një rrjedhë të parasë në të ardhmën. Duket se kjo e arkëtueshme është mbetur e papaguar shumë gjatë dhe nëse shuma nuk ka mundësi të arkëtohet atëherë duhet të shlyhet si borxh i keq dhe të njihet shpenzimi përkatës. Ka mundësi që pasuritë dhe fitimet të jenë mbivlerësuara.

Edhe pse përfaqësimi nga menaxhmenti është pranuar në të cilën tregohet se shuma do t'i paguhet Dafi Shpk, auditori duhet të jetë skeptik për të pohim pasi që përfaqësim i njëjtë është dhënë edhe vitin e kaluar dhe shuma nuk ishte arkëtuar më vonë. Shuma prej €25,000 mund të arkëtohet në një afat më të gjatë, në të cilin rast kjo llogari e arkëtueshme do të mund të riklasifikohej si pasuri jo-qarkulluese. Shuma që i është dhënë Jani mund të jetë një investim se sa një llogari e arkëtueshme afat-shkurtë. Klasifikimi i saktë në bilancin e gjendjes është shumë i rëndësishëm për të paraqitur si duhet pozitën e likuiditetit të kompanisë në fund të vitit.

(ii) Procedurat e mëtutjeshme të auditimit:

Kërkoni nga Arlind Bakia një përfaqësim të shkruar në të cilin paraqiten detajet e:

- natyrës së saktë të kontrollit mbi Jani Shpk, dmth nëse ai është aksionar atëherë të tregohet përqindja e aksioneve, nëse është anëtarë i menaxhmentit senior atëherë të tregohen pozita e saktë brenda entitetit,
- një koment nëse sipas pikëpamjes së tij kjo shumë do të arkëtohet,
- një datë specifike deri në të cilën kjo shumë do të pritet të paguhet dhe
- një konfirmim se nuk ka saldo tjera të papaguara nga Jani Shpk ose nuk ka transaksione tjera në mes të Dafi dhe Jani.

Rishikoni kushtet e konfirmimeve të shkruara për shumën, siç janë marrëveshja e nënshkruar ose fatura, duke kontrolluar nëse ka ndonjë interes të papaguar ndaj Dafi Shpk. Kushtet duhet të rishikohen për detajet e ndonjë sigurimi të ofruar dhe natyrën e formës së pagesës.

Nga diskutimi me Arlindin, krijoni njohuri për çëllimin biznesor të këtij transaksioni, veçanërisht të kuptohet nëse saldoja është e arkëtueshme tregtare apo investim.

Rishikoni procesverbalët e takimeve të bordit për të marrë dëshmi për diskutimet e transaksionit dhe mundësinë e arkëtimit të shumës së papaguar. Merrni pasqyrat financiare të fundit të audituara të Jani Shpk dhe:

- verifikoni nëse Arlind Bakia është shpalosur si palë kontrolluese ose është shpalosur si njëri nga anëtarët e personelit kyç të menaxhmentit,
- ekzaminoni shënimet sqaruese për të gjetur çfardo shpalosje të transaksionit ku do të duhej të përshkruhej si detyrim nga palët e ndërlidhura, dhe
- kryeni një analizë të likuiditetit për të përcaktuar nëse shuma mund të ripaguhet nga pasuritë likuide të kompanisë.

(b) Çështjet e kontrollit të cilësisë të ngritura nga komentet e seniorit të auditimit

Ka disa çështje të ngritura, të gjitha nga të cilat tregojnë se procedurat e kontrollit të cilësisë nuk kanë funksionuar mjaftueshëm. Procedurat e planifikuara të auditimit duken të jenë të pamjaftueshme, do të duhej të kryheshin teste të mëtutjeshme për të konfirmuar plotësinë, ekzistencën dhe vlerësimin e saldosh.

Gjatë auditimit të vitit të kaluar, përfaqësimet nga menaxhmenti janë pranuar si dëshmi të mjaftueshme në lidhje me atë të arkëtueshme. Ka mundësi se ky zë nuk është identifikuar si transaksion në mes të palëve të ndërlidhura ose nuk është konsideruar të jetë material sa duhet për të kryer hetime të mëtutjeshme.

Në fazën e planifikimit, është procedurë standard të identifikohen palët kyçe të ndërlidhura të entitetit dhe të planifikohen procedurat specifike për ato. Planifikimi i pamjaftueshëm mund të çojë në mungesën e vendosjes së prioritetëve në këtë fushë me rrezik relativisht të lartë të auditimit.

Puna në të arkëtueshmet shpesh kryhet nga antëtarë relativisht pa-përvojë të skuadrës së auditimit. Juniorët e auditimit mund të mos e shohin shkeljen e mundshmë të SNK 24 ose kompleksitetin sa i përket vlerësimin të materialitetit për këtë lloj të transaksionit.

Rishikim i pamjaftueshëm nga menaxheri i auditimit i letrave të përfunduara të punës dhe si rezultat ka dështuar të vërej dobësinë në përfaqësimin e menaxhmentit si burim i dëshmisë. Këtë vit seniori i auditimit e ka nënvizuar këtë çështje e cila mund të zgjidhet përmes procedurave shtesë të auditimit.

(c) SNA 510 Angazhimet fillestare – Saldot fillestare kërkon të kryhen procedurat të caktuara të angazhimet fillestare të auditimit në rastet kur pasqyrat financiare të vitit të mëparshëm nuk janë audituar.

Së pari, nga auditori kërkohet të lexojë pasqyrat financiare të fundit për informatat që janë relevante për saldosh fillestare, përfshirë shpalosjet.

Pastaj auditori duhet të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme nëse saldosh fillestare përmbajnë anomali të cilat mund të ndikojnë materialisht në pasqyrat financiare të vitit aktual. Në këtë aspekt së pari duhet të përcaktohet nëse saldosh përfundimtare të vitit të kaluar janë bartur saktë në vitin aktual.

Auditori po ashtu duhet të përcaktojë nëse saldosh fillestare reflektojnë zbatimin e politikave të duhura kontabël.

Varësisht nga natyra e saldove fillestare, duhet të kryhen procedurat specifike të auditimit në ato saldo fillestare. Procedura shtesë të auditimit nevojiten për llogaritë të cilat duket se kanë anomali materiale.

Në fund, auditori duhet të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit nëse politikat e kontabilitetit që reflektohen në saldosh fillestare janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në pasqyrat financiare të periudhës aktuale dhe çfardo ndryshimi në politikat kontabël është trajtuar dhe shpalosur në pajtueshmëri me SNK 8 Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet.

Lidhur me saldon fillestare të stoqeve, procedurat e rekomanduara janë siç vijon:

- Inspektimi i të dhënave për numërimet e stoqeve para fundit të periudhës 31 dhjetor 2015, për të konfirmuar se sasia e artikujve përputhet me të dhënat kontabël.
- Vëzhgimi i numërimit të stoqeve për vitin aktual me 31 dhjetor 2016 dhe harmonizimi i sasive në saldon përfundimtare me saldon fillestare.
- Procedurat analitike për marzhën e fitimit brutor, duke krahasuar saldot fillestare dhe përfundimtare të marzhës së fitimit bruto për lloje të ndryshme të stoqeve.
- Verifikimi i vlerës së shitjeve në vitin aktual financiar të artikujve që kanë qenë në stok me 31 dhjetor 2015 dhe krahasimi i vlerës së shitjeve me koston. Duhet të përtohen dëshmi se stoqet janë vlerësuar me kosto ose VNRV cilado që është më e ulët.
- Inspektimi i pasqyrave menaxheriale për dëshmi të artikujve të stoqeve të cilat janë shlyer në periudhën aktuale - kjo është shumë e rëndësishme për stoqet e kalendarëve dhe ditarëve me data të cilat nuk mund të përdoren në vitet tjera.
- Diskutimi me menaxhmentin lidhur me lëvizjet e ngadalta të stoqeve të cilat janë përfshirë në saldon fillestare të stoqeve.
- Procedurat analitike siç është llogaritja e qarkullimit të stoqeve duke nënvizuar stoqet që lëvizin ngadal nga saldoja fillestare.

(d) Raportimi mashtrues financiar është lloj i mashtrimit që shkakton anomali materiale në pasqyrat financiare.

Termi është përkufizuar në SNA 240 *Përgjegjësia e auditorit në lidhje me mashtrimin në një auditim të pasqyrave financiare (e ri-draftuar)*. Raportimi financiar mashtrues është veprim i qëllimshëm, dmth, një anomali e qëllimshme dhe mund të përfshijë shmangiet.

Qëllimi i veprimit është të mashtrohen shfrytëzuesit e pasqyrave financiare. Raportimi financiar mashtrues tenton të bi në tre kategoritë e përshkruara më poshtë:

Manipulimi dhe falsifikimi ose ndryshimi i regjistrave kontabël ose dokumenteve mbështetëse nga të cilat janë përgatitur pasqyrat financiare. Një shembull do të ishte ku menaxhmenti ndryshon me qëllim bilancin vërtetues i cili më pastaj është përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare. Regjistrimet fiktive mund të përdoren për të përmirësuar 'dukjen' e shifrave të fund-vitit.

Keqinterpretimi ose shmangia me qëllim e ngjarjeve nga pasqyrat financiare ose e transaksioneve ose e informatave domethënëse. Një shembull mund të jetë kur menaxhmenti me dijeni ka dështuar të trajtoj në kontabilitet një transaksion dhe për arsye pasqyrat financiare nuk janë të plota. Të hyrat ose kostot mund të regjistrohen ose të shtyhen deri në periudhën e ardhshme kontabël. Dështimi për të ofruar informata për problemet me parimin e vijimësisë është shmangie me qëllim e një informate domethënëse.

Keq-zbatimi me qëllim i parimeve të kontabilitetit sa i përket shumave, kalsifikimit, prezentimit dhe shpalosjes në pasqyrat financiare. Një shembull mund të jetë shkelja me qëllim i një standardi të raportimit financiar. Kjo do të thotë se saldot janë njohur në mënyrë jot ë përshtatshme, nuk janë bërë shpalosjet e nevojshme ose prezentimi nuk është i saktë. Veprime të tilla shpesh kryhen për të menaxhuar fitimet në mënyrë që të influencohet perceptimi për performancën e kompanisë.

Kësaj zakonisht i referohemi si 'menaxhimi i fitimeve' dhe ka mundësi të ndodhë si rezultat i presioneve mbi menaxhment për të arritur targete të caktuara të performancës. Në mënyrë alternative, pasqyra e pozitës financiare të kompanisë mund të manipulohet me qëllim të sigurimit të financimit.

Detyra 2

(a) Udhëzimet për ngjarjet pas datës së raportimit janë të dhëna në *SNA/ISA 560 Ngjarjet pasuese*.

Kërkohe:

Sqaroni përgjegjësitë e auditorit në lidhje me ngjarjet pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar.
(8 pikë)

(b) Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e Pipi shpk, një kompani prodhuese me fundvitin në 31 tetor 2016. Gjatë vitit të kaluar janë blerë disa prona investuese për të përdorur fondet e tepërta dhe të sigurojë të ardhurat nga qiraja. Pronat janë rivlerësuar në fund të vitit në përputhje me SNK 40 *Pronat Investuese*, ato njihen në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë prej €8 milion dhe pasuritë totale të Pipi shpk janë €160 milion në 31 tetor 2016. Është përdorur vlerësuesi i jashtëm për vlerat e drejta të secilës pasuri.

Kërkohe:

(i) Rekomandoni për bisedat/pyetjet të cilat duhet të bëhen në lidhje me vlerësuesin e jashtëm, para se të mbështeteni në punën e tyre dhe spjegoni arsyet për këto pyetje. (9 pikë)

(ii) Identifikoni dhe sqaroni procedurat kryesore të auditimit të cilat duhet të ndërmerren për vlerësimin e pronave investuese. (8 pikë)

[Total: 25 pikë]

Zgjidhja

(a) Përgjegjësitë e auditorit në lidhje me ngjarjet pas datës së bilancit të gjendjes

Ngjarjet pas datës së bilancit të gjendjes janë ato ngjarje të cilat ndodhin në mes të datës së pasqyrave financiare dhe datës së raportit të auditorit dhe poashtu faktet të cilat janë zbuluar pas datës së raportit të auditorit.

SNA /IAS 560(I Ridraftuar) Ngjarjet pas datës së Bilancit të Gjendjes i diferencon përgjegjësitë e auditorit për këto ngjarje varësisht nga koha kur ndodhin ato.

Ngjarjet të cilat ndodhin deri në datën e raportit të auditorit. Auditori ka punë aktive për t'i performuar procedurat e auditimit të dizajnuara për të identifikuar dhe për të mbledhur evidenca të mjaftueshme të të gjitha ngjarjeve deri në datën e raportit të auditorit të cilat mund të kërkojnë korrigjime ose shpalosje në pasqyrat financiare. Këto procedura duhet të kryhen sa më afër të jetë e mundur me datën e raportit të auditorit dhe përveç kësaj përfaqësimet do të kërkojnë në datën kur është nënshkruar raporti.

Procedurat do të përfshijnë rishikimin e procedurave të menaxhmentit për të siguruar se janë identifikuar ngjarjet pas datës së bilancit të gjendjes, duke lexuar minutat e mbledhjes së aksionarëve dhe menaxhmentit, duke rishikuar informatat e fundit të ndërmjetme financiare dhe duke bërë hetimet e duhura ndaj menaxhmentit.

Kur zbulohet ngjarja materiale pas datës së bilancit të gjendjes, auditori duhet të marrë në konsiderim nëse menaxhmenti ka regjistruar dhe shpalosur ngjarjet në pasqyrat financiare në përputhje me *SNK 10 Ngjarjet pas datës së Bilancit të Gjendjes*.

Faktet e zbuluara pas datës së raportit të auditorit por para datës kur pasqyrat financiare janë publikuar. Auditori nuk ka përgjegjësi për të kryer procedurat e auditimit ose të bëjë hetim në lidhje me pasqyrat financiare ose ngjarjet pas datës së bilancit të gjendjes pas datës së raportit të auditorit. Në këtë periudhë, është përgjegjësi e menaxhmentit të informojë auditorët për faktet të cilat mund të ndikojnë në pasqyrat financiare.

Kur auditori të jetë në dijeni të fakteve të cilat mund të kenë ndikim material në pasqyrat financiare, çështja duhet të diskutohet me menaxhmentin. Nëse pasqyrat financiare janë ndryshuar sic duhet atëherë duhet të lëshohet raporti i ri i auditimit dhe procedurat në lidhje me ngjarjet pas datës së bilancit të gjendjes duhet të shtyhen deri në datën e raportit të ri. Nëse menaxhmenti nuk i ndryshon pasqyrat financiare për të reflektuar ngjarjet pas datës së bilancit të gjendjes, atëherë duhet të lëshohet raporti me rezervë ose i kundërt ose një mohim.

Faktet e zbuluara pasi që janë publikuar pasqyrat financiare. Pasi që janë lëshuar pasqyrat financiare, auditori nuk ka obligim që të bëjë hetim në lidhje me pasqyrat financiare. Megjithatë, auditori mund të jetë në dijeni të fakteve të cilat kanë ekzistuar në datën e raportit të auditimit, të cilat nëse kishin qenë të njohura në këtë datë do të kërkonin modifikim të raportit të auditorit.

Në këtë rast çështja duhet të diskutohet me menaxhmentin. Kjo mund të rezultojë në rishikim të pasqyrave financiare në të cilin rast auditori duhet të lëshojë një raport të ri të auditimit për pasqyrat e rishikuara financiare. Ky raport duhet të përfshijë, me theks të vecantë në paragrafin në të cilin i referohet shënimit në pasqyrat financiare, në të cilin diskutohen të gjitha arsyet për rishikim. Nëse menaxhmenti nuk i rishikon pasqyrat financiare, auditori duhet të marrë këshilla ligjore me qëllim që të parandalojë mbështetjet e mëtutjeshme në raportin e auditorit.

(b) (i) Hetimet në raport me vlerësuesin e jashtëm

Duhet të bëhen hetime për dy arsye kryesore, së pari për të përcaktuar kompetencat, dhe së dyti objektivitetin e vlerësuesit. *SNA 620 Përdorimi i punës së ekspertit përfshin* udhëzime në këtë drejtim:

Kompetencat

Hetimet duhet të përfshijnë:

- A është vlerësuesi anëtar i një organizmi të njohur profesional, për shembull një shoqate kombëtare apo ndërkombëtare ?
- A posedon vlerësuesi ndonjë licencë për të kryer vlerësimet e kompanisë?
- Sa gjatë ky vlerësues ka qenë anëtarë i një trupi të njohur profesional ose sa gjatë ka licence?
- Sa ka eksperiencë vlerësuesi në aspektin e vlerësimit të Pronave Investuese?

-A ka eksperiencë vlerësuesi në aspektin e vlerësimit të Pronave Investuese me qëllim të përcaktimit të vlerave të drejta të tyre?

- A ka evidenca të reputacionit të vlerësuesit, p.sh referenca profesionale, rekomandime nga kompanitë tjera për të cilat ka kryer këto shërbime?

- Sa ka eksperiencë vlerësuesi me Pipi?

Duke përdorur hetimet e mësipërme, auditori përpjeket që të formojë një opinion për relevancën dhe besueshmërinë në vlerësimet e paraqitura. *SNA 500 Evidencat e Auditimit* kërkon që auditori të gjenerojë evidenca të cilat janë të mjaftueshme dhe të nevojshme.

Auditori ka nevojë të sigurojë që vlerat e drejta të paraqitura në pasqyrat financiare nga ana e vlerësuesit janë të bazuara në njohuri dhe aftësi të cilat dëshmojnë me anëtarësinë e vlerësuesit në organizma profesional dhe nëse ai ka licencë.

Është e rëndësishme që të vlerat e drejta është arritur përmes metodave të lejuara nga *SNK 40 Pronat Investuese*. Nëse janë përdorur metodat tjera të vlerësimit atëherë vlera e njohur në pasqyrat financiare mund të mos jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

Andaj është e rëndësishme të kuptohet nëse vlerësuesi ka përvojë të mjaftueshme specifikisht në ofrimin e vlerësimeve të cilat janë në përputhje me *SNK 40* dhe sa herë vlerësuesi ka kryer shërbime të tilla për të vlerësuar pasuri të tilla si ato në pronësi të Pipi.

Gjatë vlerësimit të besueshmërisë së vlerës së drejtë, auditori mund të dëshirojnë të marrin në konsideratë se si Pipi shpk vendosi të emërojë këtë vlerësues të veçantë p.sh. në bazë të një rekomandimi, ose pas marrjes referenca nga kompanitë për të cilin vlerësimet më parë ishin dhënë. Gjithashtu do të jetë e rëndësishme të marrin në konsideratë se si vlerësuesi është i njohur me biznesin e Pipi dhe të mjedisit, si një mënyrë për të vlerësuar besueshmërinë dhe përshtatshmërinë e çdo supozime të përdorura në teknikë vlerësimi.

Objektiviteti

Hetimet duhet të përfshijnë:

- A ka eksperti ndonjë interes financiar në Pipi shpk, p.sh. aksione të cilat mbahen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në kompani?

- A ka vlerësuesi ndonjë marrëdhënie personale me ndonjë drejtor apo punonjës të Pipi shpk?

-A është çmimi i paguar për shërbimin e vlerësimit i arsyeshëm dhe i drejtë, i bazuar në çmimin e tregut?

Me këto hetime, auditori është duke fituar siguri se vlerësuesi do të kryejë vlerësimin nga një pikëpamje e pavarur. Nëse vlerësuesi kishte një interes financiar në Pipi shpk, do të jetë nxitje për të manipuluar vlerësimin në një mënyrë më të mirë të përshtatshme për pasqyrat financiare të kompanisë

Njëlloj, nëse vlerësuesi kishte një marrëdhënie personale me një anëtar të lartë të stafit në Pipi shpk, vlerësuesi mund të ketë presion për të dhënë një mendim të favorshëm për vlerësimin e pronave. Niveli i çmimit të paguar është i rëndësishëm. Ai duhet të jetë në përputhje me normën e tregut të paguar për këtë lloj të vlerësimit. Nëse vlerësuesi është paguar në tejkallim të asaj që mund të konsiderohet një tarifë normale, ajo mund të tregojnë se vlerësuesi është inkurajuar, ose madje edhe të korruptuar, për të siguruar një vlerësim të favorshëm.

(ii) Procedurat shtesë të auditimit Procedurat e Auditimit duhet të përqendrohet në vlerësimin e punës së ekspertëve vlerësues. Procedurat mund të përfshijnë si në vijim:

- Inspektimi i udhëzimeve me shkrim të dhënë nga Pipi shpk tek eksperti, i cili duhet të përfshijë çështje të tilla si objektive dhe fushëveprimin e punës vlerësuesit, shkalla e qasjes së ekspertit për të dhënat përkatëse dhe fotografitë.

- Vlerësimi, duke përdorur raportin e vlerësimit, që çdo supozim i përdorur nga vlerësuesi është në përputhje me njohuritë e auditorit dhe të kuptuarit e Pipi shpk. Çdo dokumentacion i cili mbështet supozimet e përdorura nga vlerësuesi duhet të rishikohet për konsistencë me kuptimin e auditorit për biznesin, si dhe për konsistencë me ndonjë evidencë tjetër të auditimit.

- Vlerësimi i metodologjisë së përdorur për të arritur në vlerat e drejta dhe konfirmimi se metoda e përdorur është konsistente me atë të kërkuar sipas *SNK 40*.

-Auditori duhet të konfirmojë, duke përdorur raportin e vlerësimit, që një metodë konsistente është përdorur në vlerësimin e çdo prone.

-Gjithashtu të jetë konfirmuar se data e raportit të vlerësimit është arsyeshmërisht afër fundit të vitit të Papi shpk.

- Inspektimi fizik i pronave investuese për të përcaktuar kushtet fizike të pronave të cilat mbështesin vlerësimin.

-Inspektimi i dokumentacionit për blerjen e çdo prone investuese për të konstatuar koston e çdo ndërtese Pasi që pronat janë blerë gjatë kësaj periudhe të kontabilitetit, do të ishte e arsyeshme të pritet se vlera e drejtë në fund të vitit nuk është në thelb e ndryshme nga çmimi i blerjes. Çdo rritje ose ulje të konsiderueshme në vlerë duhet të paralajmërojë auditorin për anomali të mundshme, dhe të çojë në procedurat të mëtutjeshme të auditimit.

- Rishikimi i planifikimeve të të hyrave nga qeraja të pronave investuese-duke mbështetur evidencat e vlerësimit.

- Ngjarjet pas datës së Bilancit të Gjendjes duhet të mbikqyren për ndonjë evidencë shtesë në lidhje me vlerësimin e pronave.

Për shembull, shitja e pronave investuese menjëherë pas fundit të vitit mund të ofrojë evidencë shtesë në lidhje me matjen e vlerës së drejtë.

- Merrni një përfaqësim të menaxhmentit në lidhje me arsyeshmërinë e ndonjë supozimi të rëndësishëm, ku është e nevojshme, për matjet e vlerës së drejtë apo shpalosjet.

Detyra 3

(a) Diskutoni marrëdhënien në mes të koncepteve të 'rrezikut të auditimit' dhe 'rrezikut të pasqyrave financiare'. (4 pikë)

(b) Ju jeni në dijeni që klienti juaj është duke kërkuar të listohet në shtator 2017. Rregullat e listimit kërkojnë që informatat e brendshme financiare të publikohen në mes të periudhës së kontabilitetit dhe që këto informata të jenë të përcjellura edhe me një raport të rishikimit të lëshuar nga auditori i pavarur kompanisë.

Kërkohet:

Sqaroni procedurat analitike kryesore të cilat duhet të përdoren për të mbledhur evidenca për rishikimin e informatave të ndërmjetme financiare. (4 pikë)

(c) Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e Blodini shpk, një kompani e listuar, për vitin që përfundon më 31 mars 2017. Firma juaj është caktuar si auditor i Blodini shpk në shtator 2016. Puna e auditimit është përfunduar dhe ju jeni duke i rishikuar letrat e punës me qëllim të përgatitjes së draft raportit për personat e ngarkuar me qeverisjen. Pasqyra e pozicionit financiar tregon pasuri në total prej €78 milion (2016 - €66 milion). Aktiviteti kryesor biznesor i Blodini shpk është prodhimi i makinerive bujqësore.

Gjatë auditimit të patundshëmërive, paisjeve dhe impijanteve të prodhimit është zbuluar se kontrollet mbi shpenzimet kapitale janë përkeqësuar gjatë vitit. Nuk është marrë autorizimi për blerjen e paisjeve të zyrës me kosto prej €225,000. Nuk janë gjetur gabime materiale gjatë procedurave të kryera të auditimit për patundshmëritë, impijantet dhe paisjet e prodhimit.

Emri tregtar i gjeneruar së brendshmi është përfshirë në pasqyrën e pozitës financiare me vlerë të drejtë prej €10 milion. Letrat e punës së auditimit tregojnë që çështja është diskutuar me drejtorin financiar, i cili ka treguar se €10 milion paraqesin vlerën e tanishme të rrjedhave të vlerësuara të parasë së gatshme në të ardhmen, të cilat do të gjenerohen nga emri tregtar. Anëtarë i skuadrës së auditimit i cili e ka përfunduar punën në auditimin e pasurive të patrupëzuara, ka shënuar se ky trajtim duket të jetë në shkelje të SNK 38 *Pasuritë e patrupëzuara* dhe se menaxhmenti refuzon të mosnjohë (ç'njohë) këto pasuri.

Probleme janë paraqitur në auditimin e stoqeve. Për shkak të mbikqyrjes së auditorëve të brendshëm të Blodini shpk, skuadra e auditimit të jashtëm nuk ka pranuar kopjen e procedurave të numërimit të stoqeve para se të ndjekin numërimin. Kjo ka shkaktuar vonesa në fillimin e numërimit të stoqeve, kur skuadra e auditimit është dashur që shumë shpejt të njoftohet vet me procedurat. Përveç kësaj, në auditimin final, kur auditori senior ka kërkuar dokumentacionin që mbështet vlerësimin final të stoqeve, ka marrë kohë dy javë që të merret informacioni sepse kontabilisti që i ka përgatitur i kishte humbur ato.

Kërkohet :

(i) Identifikoni qëllimin kryesor të përfshirjes së "të gjeturave të auditimit" (pikat e letrës së menaxhmentit) në raportin drejtuar atyre të cilët janë të angazhuar në qeverisjen e ndërmarrjes.

(5 pikë)

(ii) Nga informatat e dhëna më lartë, rekomandoni çështjet të cilat duhet të përfshihen si "të gjetura nga auditimi" në raportin tuaj drejtuar atyre të cilët janë të angazhuar në qeverisjen e ndërmarrjes dhe tregoni arsyet për përfshirjen e tyre.

(7 pikë)

d) Drejtori financiar i Blodini shpk, Ana Gashi, ka kërkuar që firma juaj të përpilojë pasqyrat financiare në formën që tu prezantohet aksionarëve në mbledhjen e ardhshme vjetore të kompanisë. Ana poashtu ka komentuar se auditorët e kaluar nuk e kanë përdorur mohimin e detyrimit në raportin e tyre të auditimit, dhe do të dëshironte më shumë informata në lidhje me përdorimin e paragrafëve të mohimit të detyrimit.

Kërkohet:

Diskutoni çështjet etike të cilat dalin në pah nga kërkesa për firmën tuaj që të përpilojë pasqyrat financiare të Blodini shpk.

(5 pikë)

[Total: 25 pikë]

Zgjidhja

(a)

Rreziku i biznesit përkufizohet si kërcënim që do të thotë se biznesi mund të dështojë të përmbush objektivat në bazë të vazhdueshme.

Rreziqet e biznesit përfaqësojnë probleme me të cilat ballafaqohet menaxhmenti dhe këto problem duhet të identifikohen dhe të vlerësohen për ndikimin e mundshëm që mund ta kenë në biznes.

Rreziku i pasqyrave financiare është rreziku që përbërs të pasqyrave financiare mund të përmbajnë anomali, përmes regjistrime të pasakta të transaksioneve ose shpalosjeve. Prandaj rreziku i pasqyrave financiare paraqet gabime të mundshme ose anomali me qëllim në pasqyrat financiare të publikuara të një biznesi.

Zakonisht ekziston një marrëdhënie direkte në mes të rrezikut të biznesit të rrezikut të pasqyrave financiare. Në përgjithësi një rrezik i biznesit nëse nuk adresohet nga menaxhmenti, do të ketë ndikim në përbërës specifik të pasqyrave financiare.

Ndonjëherë rreziqet e bizneseve kanë efekt më të përgjithshëm në pasqyrat financiare. Kontrollë të brendshme të dobëta shpesh identifikohen si rreziqe të biznesit. Pamjaftueshmëria në sisteme dhe kontrollë mund të çojnë deri te gabimet ose anomalitë në cilëndo fushë të pasqyrave financiare prandaj auditorët e perceptojnë këtë si faktor të rrezikut të përgjithshëm të auditimit.

Rreziqet e biznesit shpesh lidhen me hipotezën e vijimësisë, sepse nëse një biznes dështon të përmbush objektivat siç janë gjenerimi i paraë ose maksimizimi të të hyrave, atëherë mund të ketë vështirësi në vazhdimin e ekzistencës. Sa i përket rrezikut të pasqyrave financiare, hipoteza e vijimësisë është çështje shumë specifike dhe rreziku në këtë rast është mosshpalosja e duhur e problemeve me hipotezën e vijimësisë. Në raste ekstreme, kur biznesi përfundimisht nuk operon sipas hipotezës së vijimësisë, ka rrezik që pasqyrat financiare nuk janë përgatitur sipas bazës së vijimësisë dhe është dashur të përdoret baza e likuidimit të biznesit.

Që të dy konceptet, i rrezikut të biznesit dhe rrezikut të pasqyrave financiare mund të përdoren nga auditori për të identifikuar fushat e pasqyrave financiare që ka gjasë të përmbajnë anomali materiale. Qasja e rrezikut të biznesit e vendos auditorin 'në këpucë' të menaxhmentit dhe kështu ofron një analizë më të thellë të operacioneve të biznesit dhe arrinë një të kuptuar më të gjërë të biznesit.

(b) Udhëzimet për rishikimin e informatave të ndërmjetme financiare janë të dhëna në *ISRE2410 Rishikimi i Informatave të ndërmjetme financiare nga Auditori i Pavarur i Entitetit*.

Standardi vë në pah që auditori duhet të planifikojë punën e tij për të gjeneruar evidenca duke përdorur procedurat analitike dhe hetimore.

Auditori duhet të kryejë procedurat analitike me qëllim të zbulimit të trendeve dhe marrëdhënieve jo të zakonshme ose të zërave individual në informatat e ndërmjetme financiare të cilat mund të qojnë në anomali materiale. Procedurat duhet të përfshijnë të mëposhtmet:

Krahasimi i informatave të ndërmjetme financiare me rezultatet e parashikuara, buxhetet dhe caqet të përcaktuara nga menaxhmenti i kompanisë.

Krahasimi i informatave financiare me:

- Informatat e krahasueshme për periudhën e cila i paraprin periudhës së ndërmjetme,
- Periudhën e ndërmjetme korresponduese në vitet paraprake dhe,
- Pasqyrat më të fundit financiare të audituara

- Krahasimi i koeficientëve dhe indikatorëve për periudhën e tanishme të ndërmjetme me ato të entiteteve të së njëjtës industri.

- Marrja në konsiderim e marrëdhënieve në mes të informatave financiare dhe jo-financiare. Auditori mund të ketë poashtu në konsiderim informacionet të gjeneruara dhe në përdorim nga entiteti, p.sh. informatat në raportet financiare mujore të dorëzuara te menaxhmenti senior ose lajmet e lëshuara nga kompania të cilat janë relevante me informatat e ndërmjetme financiare.

- Krahasimi i shumave të regjistruara ose koeficientëve të gjeneruar nga këto shuma, me pritjet nga auditori. Auditori bën planifikime të tilla duke identifikuar dhe përdorur marrëdhëniet e besueshme të cilat pritet të ekzistojnë arsyeshmërisht të bazuara në kuptimin nga ana e kontabilistit të entitetit dhe të industrisë në të cilën operon biznesi.

- Krahasimi i të dhënave të ndara p.sh krahasimi i të hyrave të raportuara mujore dhe nga linja e prodhimit ose segmentit operativ gjatë periudhës së tanishme të ndërmjetme me atë të periudhave paraprake.

Nëse me procedurat analitike të kryera gjatë auditimit zbulohet nodnjë marrëdhënie e pazakontë, trend ose shumë individuale të cilat mund të cojnë në anomali materiale, duhet të diskutohen me menaxhmentin.

(c)

(i) Raporti i drejtuar atyre të cilët janë përgjegjës për pasqyrat financiare të entitetit duhet të jetë i përgatitur me qëllim që të komunikohen çështjet e lidhura me auditimin e jashtëm.

SNA 260 Komunikimi i Çështjeve të Auditimit atyre të cilët janë të angazhuar në Qeverisjen kërkon që auditorët të komunikojnë shumë çështje, duke përfshirë pavarësinë dhe çështjet tjera etike, qasjen e auditimit dhe qëllimin, detajet e përfaqësimeve të menaxhmentit si dhe të gjeturat e auditimit.

Të gjeturave të auditimit zakonisht u referohemi si pikat e letrës së menaxhmentit. Duke i komunikuar këto çështje, auditori është i sigurtë se ka dokumentacion të shkruar i cili i përshkruan të gjitha çështjet e ngritura dhe me rëndësi gjatë procesit të auditimit dhe se për këto çështje është lajmëruar formalisht nivel i lartë i menaxhmentit të klientit.

Për menaxhmentin raporti duhet të sigurojë se ata tërësisht e kuptojnë qëllimin dhe rezultatet e shërbimeve të auditimit të cilat janë ofruar dhe janë në gjendje që të ofrojnë komente për t'i ndihmuar atyre të plotësojnë detyrat e tyre në raport me pasqyrat financiare dhe sistemet e kontabilitetit dhe të kryhet kontrolli me efikasitet.

Raporti duhet poashtu të përfshijë, aty ku është relevante ndonjë veprim që menaxhmenti ka treguar se do ta ndërmerret në lidhje me rekomandimet e bëra nga auditorët.

(ii) Dobësitë e kontrollit

SNA 260 përmban udhëzime për llojet e çështjeve të cilat duhet të komunikohen. Njëra nga çështjet e identifikuar është dobësitë e kontrollit në ciklin e shpenzimeve kapitale. Pasuritë për të cilat nuk është marrë autorizimi arrijnë shumën prej 0.3% të pasurive në total (225,000/78 million x 100%), e cila është dukshëm jomaterial. Megjithatë faktin e materialitetit, auditori duhet të sigurojë që mungesa e kontrollit duhet tu bënhet me dije menaxhmentit me një qartësi të ndikimeve që mund të ketë kjo dhe rekomandimeve si të eliminohen mangësitë e kontrollit.

Auditori ofron informata për tu ndihmuar atyre të cilët janë të angazhuar me qeverisjen e entitetit, në mënyrë që të përmirësojnë sistemet dhe kontrollet dhe të zvogëlojnë rreziqet e biznesit. Në këtë rast ka rrezik të madh të mashtrimit si rezultat i mungesës së autorizimit për blerjen e paisjeve të zyrës, që do të lejonte blerjen e pasurive të cilat nuk përdoren për qëllime të biznesit.

Mospajtimi në lidhje me trajtimin në kontabilitet të markës tregtare

Procedurat e auditimit kanë treguar se sipas *SNK 38 Pasuritë e patrupëzuara*, në të cilën thuhet se shenjat tregtare të gjeneruara së brendshmi janë të ndaluara që të njihen dhe të regjistrohen në kontabilitet.

Blodini shpk ka njohur një gjë të tillë e cila është materiale në bilancin e gjendjes pasi që përfaqëson 12.8 % të totalit të pasurive (10/78 x 100%).

Pasqyra e pozitës financiare (bilanci i gjendjes) përmban anomali materiale. Raporti për ata të cilët janë të angazhuar në qeverisjen duhet qartazi të shpjegojë rregullat e njohjes së shenjave tregtare të gjeneruara së brendshmi, për të siguruar që menaxhmenti ka në dispozicion të gjitha faktet relevante teknike.

Në raport auditorët duhet të kërkojnë që pasqyrat financiare të jenë të sakta dhe të qartësojnë se nëse nuk shlyhen pasuritë e patrupëzuara të njohura më heret, atëherë opinion i auditimit do të jetë me rezervë për shkak të anomalive materiale.

Pasi që kjo pjesë e SNK 38 është bërë e qartë t'kë menaxhmenti në raportin e ofruar, atëherë ata kanë mundësi të diskutojnë çështjen dhe të vendosin nëse do të ndryshojnë pasqyrat financiare me cka mund t'i ikin opinionit me rezervë.

Mosefikasiteti i auditimit

Dokumentimi në lidhje me stoqet nuk ka qenë i gatshëm cdoherë për auditorët.

Kjo duket të jetë rezultat i administrimit të dobët nga klienti më shumë sesa përpjekje e qëllimshme për të shtyrë informacionet. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim të qartë të problemeve të identifikuara nga skuadra e auditimit. Menaxhmentit duhet tu bëhet me dije që vonesat mund të shkaktojnë joefikasitet në procesin e auditimit.

Kjo mund të duket çështje e parëndësishme por mund të ndikojë në rritjen e çmimit të auditimit.

Menaxhmenti duhet të reagojë në komentete e tilla duke siguruar që aq sa të jetë e mundur që do të sigurohen të gjitha dokumentacionet e kërkuara nga auditorët.

(d) Nuk është e pazakontë për firmat e auditimit që të përpilojnë pasqyrat financiare të klientëve të tyre, sidomos kur klienti është entitet relativisht i vogël, gjë e cila mund të reduktojë burimet dhe aftësitë për të kryer këtë punë. Kjo nuk ndalohet me standardet etike.

Megjithatë, mund të ketë kërcnim të pavarësisë, me rrezikun e paraqitur në rastin e Blodinit e cila është kompani e listuar. Auditorët mund të perceptohen të jenë të angazhuar në përgatitjen e pasqyrave financiare të klientëve të listuar, gjë e cila është e ndaluar me standardet etike.

Kodi i Etikës i IFAC paraqet se për klientët e listuar, firma e auditimit nuk duhet të jetë e angazhuar në përgatitjen e pasqyrave financiare, gjë e cila mund të krijojë kërcnim të vetë rishikimit.

Megjithatë edhe pse përpilimi i pasqyrave financiare nuk është i ndaluar me udhëzimet etike, ekziston rreziku që ofrimi i shërbimit të tillë mund të perceptohet si element i përgatitjes së pasqyrave financiare.

Është e mundshme që gjatë këtij procesi të përpilimit të pasqyrave financiare, mund të bëhen vendime dhe gjykime. Kjo mund të duket si marrje e vendimeve të menaxhmentit në raport me pasqyrat financiare, e cila qartësisht është mosrrespektim i pavarësisë së auditorit.

Për të eliminuar rrezikun e ekspozimit, vendimi i duhur do të jetë që të mos përpilohen pasqyrat financiare, duke siguruar se Blodini vlerëson problemet etike të kësaj çështjeje.

Detyra 4

(a) Beni dhe Artan Shala janë pronarë të kompanisë BA Shpk. Motra e Benit dhe Artanit, Arta, është pronare e kompanisë për dizajn, Dizi SHA.

Gjatë rishikimit të procesverbalit të takimit të bordit të drejtorëve, një rishikim i kryer si pjesë e planifikimit të auditimit të BA Shpk, është zbuluar se BA ShPK i ka paguar €225,000 kompanisë Dizi SHA lidhur me meremtmet e pronave të zhvilluara. Gjatë bisedave të mëtutjeshme, është zbulur se Dizi SHA merr me qira zyrat nga BA Shpk, sipas një marrëveshje joformale në mes të dy kompanive.

Kërkohe:

(i) Shpjegoni kufizimet e vetvetishme që do të thotë se auditorët nuk do të identifikojnë palët e lidhura dhe transaksionet në mes të palëve të lidhura, dhe (5 pikë)

(ii) Rekomandoni procedurat e auditimit që duhet të kryhen lidhur me transaksionet e BA me Dizi. (5 pikë)

(b) Firma juaj është kontaktuar nga LIBI Co për t'iofruar auditim vjetor. LIBI Co operon me një zingjir të librarive në tërë vendin. Dyqanet shesin furnizime zyre siç janë ditarët e punës dhe kalendarët si dhe libra të rinjë.

Viti financiar do të përfundojë me 31 Korrik 2017, dhe ky do të jetë viti i parë që kërkohet auditim, pasi që më parë kjo kompani ishte liruar nga auditimi sepse ishte kompani e vogël.

Partneri i mundshëm i auditimit, Geni Cako, është takuar me Teki Arifin, drejtorin menaxhues të LIBI Co sa i përket angazhimit për auditim.

Në këtë takim, Tekiu ka bërë komentet e mëposhtme:

'LIBI Co është biznes i vogël që menaxhohet nga pronari. Unë e udhëheq kompaninë së bashku me motrën time, Ritën dhe punësojmë një teknik të kontabilitetit (ende nuk është certifikuar) për të na regjistruar transaksionet dhe për t'i përgatitur pasqyrat financiare vjetore. Kontabilisti përgatit pasqyrat meanxheriale në fund të çdo tremujori, por Rita dhe unë rrallë herë bëjmë ndonjë rishikim të thellë pos që bëjmë një kqyrje të shpejtë të shifrave të shitjes në ato raporte. Ne e kuptojmë se për shkak të madhësisë së kompanisë, tani duhet të auditojmë pasqyrat financiare. Do të ishte e kuptueshme sikur firma juaj do të përgatis dhe auditojë pasqyrat financiare në të njëjtën kohë. Ne nuk duam që të përgatisim pasqyrën e rrjedhës së parasë pasi që kjo pasqyrë nuk kërkohet për qëllime të tatimeve dhe nuk do të përdoret nga ne.

Vitin e ardhshëm jemi duke planifikuar të blejmë një kompani tjetër, njërin nga konkurrentët tanë, i cili besojë është klient ekzistues i firmës tuaj. Për këtë arsye, ne kërkojmë që procedurat tuaja të auditimit mos të përfshijnë leximin e procesverbalëve të takimeve të bordit, pasi që kemi diskutuar disa çështje konfidenciale sa i përket blerjes së mundshme të kësaj kompanie'.

Kërkohe:

Identifikoni dhe shpjegoni çështjet etike dhe profesionale që mund të konsiderohen gjatë vendosjes nëse do të pranohet angazhimi si auditor i LIBI Co. (10 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja

(a) (i) Palët e lidhura dhe transaksionet me palët e lidhura janë vështirë të identifikohen. Menaxhmenti mund të mos jetë në dijeni për ekzistencën e të gjitha transaksioneve në mes të palëve të lidhura, që do të rezultojnë me mosshpalosje tek auditori. Auditorët e kompanive më të vogla shpesh e kanë të vështirë të identifikojnë transaksionet me palët e lidhura sepse menaxhmenti nuk i kupton kërkesat për shpalosje ose domethënien e shpalosjeve të kërkuara. Po ashtu mund të jetë e vështirë të vendoset nëse ekziston një marrëdhënie në mes të palëve të lidhura.

Palët e lidhura

Shpalosjet janë subjektive, po ashtu duke rezultuar në mos-shpalosje te auditori i palëve të mundshme të lidhura dhe transaksionet.

Menaxhmenti i kompanive më të mëdha mund të ketë një kuptim më të mirë të regjistrimit dhe shpalosjes së transaksioneve në mes palëve të lidhura.

Mirëpo auditorët e kompanive më të mëdha duhet të merren me transaksione më komplekse të cilat mund të jenë më të vështira të kuptohen dhe të ndiqen.

Po ashtu mund të ketë përpjekje me qëllim nga menaxhmenti për të fshehur marrëdhëniet me palët e lidhura ose transaksionet.

Njohuria e marrëdhënieve me palët e lidhura kufizohet nga menaxhmenti dhe në mungesë të procedurave alterantive përveç atyre që kanë të bëjnë me pyetjet nga auditorët, auditori nuk mund të dijë për ekzistencën e disa marrëdhënieve me palët e lidhura, veçanërisht anëtarët e familjes të menaxhmentit kyç. SNA 550 Palët e lidhura identifikon që marrëdhëniet me palë të lidhura mund të përfaqësojë një mundësi më të madhe për marrëveshje të fshehta, fshehje ose manipulim nga menaxhmenti.

Sistemi i kontabilitetit mund të mos jetë i përshtatshëm për të identifikuar transaksionet me palët e lidhura. Për shembull, pagesat me para të gatshme ndaj palëve të lidhura mund të mos jenë të identifikueshme ndaras nga pagesat ndaj furnitorëve tjerë në librat e kontabilitetit.

(ii) Procedurat e auditimit duhet të përfshijnë:

- Rishikimi i faturave të pranuar nga Shtëpia Shpk për të verifikuar shumën e shpenzimit.

Konfirmimi i pagesave me para nga libri i arkës.

- Inspektimi i llogarive të pagueshme të Shtëpia për të konfirmuar çfardo shume që është mbetura borxh në fund të vitit.

- Krahasimi i kostos së meremtit të kryer nga Shtëpia me koston e meremtimeve të kreyra nga furnitorët tjerë, për të përcaktuar nëse transaksioni është sipas parimit të gjatësisë së krahut.

- Diskutimi i qirasë joformale me menaxhmenti dhe nëse ajo shumë është e pagueshme ndaj POKO.

- Konfirmimi përmes bisedave me menaxhmentin i datës kur ka filluar marrëveshja për qira dhe periudha e pritur e qirasë.

- Pyetjet nëse ekzistojnë dokumente të shkruara lidhur me marrëveshjen për qira, nëse po, rishikimi i tyre dhe vendosja në dosje.

- Rishikimi i shpalosjeve të bëra (nëse është bërë ndonjë) lidhur me këto transaksione në pasqyrat financiare draft.

(b) Angazhimi fillestar për auditim

Pasqyrat financiare të vitit të kaluar nuk janë audituar dhe janë përgatitur nga një teknik i kontabilitetit që nuk është kualifikuar ende. Kjo çon tek rreziku i anomalive në saldot fillestare. Nëse pranohet angazhimi për auditim, duhet të planifikohen procedura për të siguruar që saldot fillestare janë bartur në mënyrë të saktë dhe reflektojnë aplikimin e politikave të përshtatshme të kontabilitetit.

Mungesa e kontrolleve të brendshme

Madhësia e vogël e kompanisë dhe fakti se është vetëm një person që i përgatit informatat për menaxhmentin lidhur me pasqyrat financiare, mund të jetë tregues se kontrollet e brendshme mund të jenë të dobëta. Për shembull, ka një fushëveprim të kufizuar për ndarjet e detyrave ose për autorizimin dhe aprovimin e kontrolleve. Përveç kësaj, duket që Tekiu dhe Rita nuk ushtrojnë kontroll menaxherial mbi procesin e raportimit financiar pasi që nuk kryejnë rishikim të detajuar të pasqyrave. Mungesa e procedurave të kontrollit të brendshëm mund të mos kuptohet se ka një rrezik të rritur të mashtrimit ose gabimit por auditori duhet të vlerësoj përshtatshmërinë e sistemit të vendosur për secilin klient specific.

Përgatitja e pasqyrave financiare

Firmës së auditimit i janë afruar për përgatitjen e pasqyrave financiare si dhe auditimin e tyre. Kjo përbën një kërcënim të vetë-rishikimit pasi që auditori i përpilon dhe i auditon pasqyrat e njëjta. Sipas Kodit të etikës për kontabilistët profesionist të IFAC, për një klient të auditimit i cili nuk është klient me interes publik, siç është rasti i LIBI, është e pranueshme të ofrohen shërbime të kontabilitetit nëse masat mbrojtëse mund të zvogëlojnë rrezikun në një nivel të pranueshëm. Për shembull, nëse shërbimet ofrohen nga individë të cilët nuk janë pjesë e ekipit të auditimit. Prandaj firma e auditimit duhet të konsiderojë nëse ka burime të mjaftueshme për të vendosur një masë mbrojtëse të tillë. Shërbimet e ofruara të kontabilitetit duhet të jenë të natyrës rutinore dhe mekanike, për të shmangur rastet që auditori të bëjë gjykime për shumat që duhet të përfshihen në pasqyrat financiare. Për shembull, klienti duhet të para-aprovtojë regjistrimet në ditarin kryesor që bëhen në bilancin vërtetues.

Pasqyra e rrjedhës së parasë

Klienti ka sugjeruar se nuk duhet të përgatitet pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme. Kjo tregon mungesën e njohurisë dhe përvojës që kanë drejtorët lidhur me çështjet e raportimit financiar. Parimi themelor i SNK 7 pasqyra e rrjedhës së parasë është se të gjitha entitetet që përgatisin pasqyra financiare në pajtueshmëri me SNRF kërkohet të prezantojnë pasqyrën e rrjedhës së parasë. Njëra nga parakushtet për auditim e referuar në SNA 220 Pajtimi me kushtet e angazhimit për auditim, që duhet të jetë prezente është që menaxhmenti pranon dhe kupton përgjegjësinë e tij për përgatitjen e pasqyrave financiare. Kjo çështje duhet të diskutohet me Tekiun dhe Ritën dhe vetëm pasi që ata të pranojnë përgjegjësinë e tyre për përgatitjen e pasqyrës së rrjedhës së parasë, të pranohet angazhimi për auditim.

Konflikti i interesit

Firma e auditimit tashmë ofron shërbime të auditimit për konkurrencën e LIBI, që çon në konflikt potencial të interesit nëse do të pranohet angazhimi. Kodi i etikës e identifikon konfliktin potencial të interesit siç është ofrimi i shërbimeve të auditimit për entitetet konkurreuese si kërcënim i mundshëm i objektivitetit. Madhësia e kërcënimit duhet të vlerësohet dhe të konsiderohen masa të përshtatshme të mbrojtjes siç janë shpалosja e konfliktit të interesit tek të gjitha palët dhe kërkimi i pajtimit nga të dy entitetet e involvuara dhe përdorimi i ekipeve të ndara të angazhimit (po ashtu e njohur si Muri Kinez).

Kufizimi i mundshëm i fushëveprimit

Tekiun deklaroi se ai nuk dëshiron të lejojë qasje auditorit në procesverbalet e takimit të bordit, pasi që përmbajnë informata konfidenciale.

Auditori ka të drejtë qasjeje për të gjitha informatat që janë relevante në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe SNA 210 kërkon që auditori të marrë pajtimin e menaxhmentit për të ofruar informata të tilla si parakusht në pranimin e angazhimit për auditim. Kjo çështje duhet të diskutohet me Tekiun dhe Ritën. Mund të ndodhë që ata nuk janë në dijeni që auditori duhet të ketë qasje të pakufizuar në librat, regjistra, përfshirë procesverbalet e takimit të kompanisë. Po ashtu ata mund të mos jenë në dijeni për parimin e konfidencialitetit të auditorit. Pasi që kjo çështje të diskutohet, klienti duhet të jetë i kënaqur ti lejojë qasje në procesverbalet e takimit të bordit. Megjithatë, nëse mbetet një kufizim në fushëveprim, nuk mund të pranohet angazhimi për auditim.